



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assembly

Data: 18.10.2018		Vendi: Kaçanik
Nr. orig.	Numri	Shtojcë
01	370/01-34247	

## KONTRATË PËR FURNIZIME

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.T.P "Ekslusive Frashëri Center" nga Ferizaji me NRF 600064414 të cilën e përfaqëson Adem Zeqiri pronar nga Ferizaji (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara më poshtë:

Furnizim me mobilje për QKMF-në në Kaçanik

me numer identifikues: 652-18-6481-1-2-1

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë dërgesa nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Furnizim me mobilje për QKMF-në në Kaçanik në 652-18-6481-1-2-1.

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

2. Kontrata hynë në fuqi me 19.10.2018 dhe përfundon më 26.11.2018.

2.1 Afati kohor për dorëzimin do të jetë tri (3) ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë *QKMF Kaçanik*

2.3 Inkotermi<sup>1</sup> i zbatueshëm do të jetë *(shëno inkotermin)*.

### Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

### Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 16,816.00 €;  
Gjashtëmbdhjetë mijë tetëqind gjashtëmbdhjetë euro e 00/100 Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshirohet ndryshimeve.

<sup>1</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim:

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqipe]<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	18.10.2018

#### Për Furnizuesin

Emri:	Adem Zeqiri
Pozita:	pronar
Nënshkrimi:	
Data:	18.10.2018

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

## 2. PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato ja relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	Sigurimi i ekzekutimit 1,681 60€
Sigurimi	10.1	<i>[Specifikoni kërkesat specifike të sigurimit]</i>
Programi i ekzekutimit	11	
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	<i>Tatimet dhe obligimet tjera i bartë OE.</i>
Patentat dhe licencat	13.1	<i>[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]</i>
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>[Shëno nëse pranimit paraprak teknik është i nevojshëm]</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<i>[Specifikoni vendin ku do të inspektohen mallrat]</i>
Pagesa	20.1	Pagesat do të bëhen pas pranimit të materialit dhe ate me dy situacione pas pranimit te furnizimeve .
Dorëzimi	21.3	<i>Dorzimi në QKMF</i>
Obligimet garancionit	24.1	<i>Sigurimi i kualitetit 365+30 ditë</i>
	24.5	<i>[Specifikoni ndonjë obligim shtesë sipas garancisë]</i>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të siguroj dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>

<p>Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore</p>	<p>32.1</p>	<p><i>[shëno të dyja]</i></p> <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i>.</p>
--	-------------	---